



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.47 dt.27.03.1998

**PER
MIRATIMIN E PROJEKTEVE KULTURORE PER VITIN 1998
TE DREJTORISE SE KULTURES, ARSIMIT E SPORTIT**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin e Drejtorisë së Kulturës, Arsimit dhe Sportit për miratimin e veprimtarive kulturore artistike dhe të projekteve kulturore të kësaj drejtorie dhe të fondeve që duhen për realizimin e tyre mbështetur në ligjin Nr.7572, neni.45, pika.16

V E N D O S I

1. Të miratojë projektet kulturore dhe fondeve që nevojiten për realizimin e tyre për vitin 1998.

Projekti kulturor Nr.1

Festivali European i Këngës për fëmijë 1998
28 - 31 Maj 1998 – Ministria e Kulturës, Bashkia e Tiranës,
Shoqata muzikore “Penton” – Një pjesë e shpenzimeve do të realizohen nga Bashkia e Tiranës – Drejtoria e Kulturës
Shpenzime ushqim + fjetje të pjesshme + grupi realizues – organizator = 1.541.000 lekë.

Projekti kulturor Nr.2

Festivali i Interpretuesve të Muzikës së Re.

Nikolla Zoraqi – Shoqata e Muzikës së Re Shqiptare, Bashkia e Tiranës. Drejtoria e Kulturës do të mbulojë shpenzimet për çmimet, jurinë dhe komitetin organizativ. Shuma 160 mijë lekë.

Projekti kulturor Nr.3

Festivali i Këngës Popullore qytetare 1998. Drejtoria e Kulturës. Shpenzime për përgatitjen e programit, fletë palosjen, shpenzime udhëtimi, dieta, orkestracione etj. Shuma 110 mijë lekë për stafin drejtues, organizues orkestrantë, këngëtare, valltare etj.

Projekti kulturor Nr.4

Orkestra frymore e Bashkisë së Tiranës.

1.Orkestrante 35 vetë x 2 koncerte në muaj me nga 1.500 lekë për çdo koncert publike duke përfshirë këtu edhe kohën e provave 2 herë në javë (16.00 – 20.00) dhe me veglat e tyre private.

35 orkestrante x 2 koncerte në muaj x 1.500 lekë për çdo koncert publik x 12 muaj.

2.Udhëheqësi artistik : Kujdesi për repertorin dhe nivelin artistik të koncerteve etj 5.000 lekë në muaj x 12 muaj = 60.000 lekë.

3.Dirigjenti i orkestrës 5.000 lekë në muaj x 12 muaj = 60.000 lekë.

4.përgjegjësi i orkestrës do të merret me lajmërimet, partiturat dhe disiplinën 4.000 lekë në çdo muaj x 12 muaj = 48.000 lekë.

5.garderoba : 500 lekë për çdo koncert mirëmbajtje e kostumeve, hekurosja etj 2 x 500 = 1.000 lekë x 12 muaj = 12.000 lekë.

Shuma e përgjithshme = 1.200.000 lekë.

Projekti Kulturor Nr.5

Rinfest 1998. Festivali i Zërave të Rinj të shkollave të kryeqytetit Drejtoria Arsimore + Drejtoria e Kulturës. Për realizimin e këtij aktiviteti shpenzime për krijimtarinë interpretimin , çmimet, jurinë, stafin krijues dhe realizues, reklamacionin etj. Shuma 95 mijë lekë.

Projekti kulturor Nr.6

Festivali i këngës për fëmijë të Tiranës 1998. Qendra Kulturore e fëmijëve, Drejtoria e Kulturës. Shpenzime për krijimtarinë, stafin krijues dhe realizues, reklamacionin etj 150 mijë lekë.

Projekti kulturor Nr.7

Festivali i Muzikës së Re Shqiptare 1998. Shoqata Muzikore e Re – Bashkia e Tiranës, për çmimet, stafin drejtues dhe organizues, reklamacionin etj. 500 mijë lekë.

Projekti kulturor Nr.8

Expo – Musique – Dita Ndërkombëtare e Muzikës. Në bashkëpunim Drejtoria e Kulturës – Ambasada e Francës – Shoqëria Artistike “Tirana 2000”.

Për stafin organizues foto ekspozite një grup i ftuar nga jashtë – reklamacioni etj. 157 mijë lekë.

Projekti kulturor Nr.9

Spektakli Sofra TIRANASE në formë panairi, ekspozitë e kulturës popullore. Shfaqje artistike, çmime etj 500 mijë lekë.

Projekti kulturor Nr.10

Konkursi i pianistëve të rinj EPTA – 1998. Për çmimet e konkursit stafin organizues, reklamacioni etj. 95 mijë lekë.

Projekti kulturor Nr.11

Ditët Ndërkombëtare të Muzikës së Re të Dhomës 98. Është konceptuar sivjet si “Forumi Ndërkombëtar i Arteve – Tiranë” (International Arts Forum Tirana) do të ketë :

- 1.Festivali i Muzikës së Re të Dhomës (5 koncerte)
- 2.Festivali i Artit Figurativ (4 ekspozita pikturë Foto)
- 3.Festivali i Filmit. Çdo natë 3-4 filma të huaj dhe shqiptarë.
- 4.Festivali i Muzikës Klasike ; interpretues, koncertistë
- 5.Program edukativ leksione – biseda me karakter informativ ideo – estetik sipas preventivave të paraqiten kërkesa për sponsorizime nga Bashkia e Tiranës. 550 mijë lekë.

Projekti kulturor Nr.12

Festivali i Romancës Shqiptare 1998.
Shoqata T.Harapi - Drejtorja e Kulturës
Shpenzime për krijimtarinë çmime, reklamacion tekste etj.
Shuma 200 mijë lekë.

Projekti kulturor Nr.13

Mbrëmje artistike e verës në Tiranë.
Çdo të premte dhe të shtunë para Q.N.Kulturës, spektakël, humor, këngë, cirk, konkurs me artistë të trupave profesioniste të kryeqytetit . Teatri i Varietesë, Cirku , Teatri i Kukullave. Nga data 20 Qershor deri 20 Gusht 1998, 8 koncerte premierë për çdo koncert 60 mijë lekë – shpërblimi krijimtari interpretim.
8 x 60 mijë = 480 mijë lekë

Projekti kulturor Nr.14

Njëshi i Tiranës – qyteti i Tiranës dhe fituesit e çmimeve të vitit në fushën e artit, letërsisë, kulturës (krijimtari, interpretim, spektakël), Fituesit e fituesve ose “Ngadhënjimtarët e vitit 1998”. Për realizimin e këtij spektakli të ri, çmime, dekor, interpretim, publicitet, reklamacion, tekste, foto etj. 500 mijë lekë.

Projekti kulturor Nr.15

Konkurs i fjalës artistike me aktore profesionistë - Duke shfletuar botimet poetike të vitit 1998. Mbrëmje poetike + muzikë e romanca të zgjedhura. Për krijimtari interpretim, çmimet, reklamacionin etj 250 mijë lekë.

Projekti kulturor Nr.16

Mbrëmja artistike me krijimtarinë më të mirë të kompozitorëve tanë. Për 6 anëtarë, krijimtaria më e mirë në vite si dhe krijimtaria e re e paekzekutuar. Realizimi në bashkëpunim me orkestrën simfonike në RTV dhe Teatrin e Operas. 6 koncerte për çdo muaj nga 80 mijë lekë = 480 mijë lekë (krijimtari, interpretim, publicitet etj).

Projekti kulturor Nr.17

Koncert i vitit të ri për fëmijë 1999.
Shpenzime për spektaklin – lodra etj – 250 mijë lekë.

Projekti kulturor Nr.18

Koncert festiv i vitit të ri 1999 për të rritur. Spektakël – krijimtari, interpretime, dekori – reklamacioni etj – 660 mijë lekë.

Projekti kulturor Nr.19

Përvjetore të artistëve dhe figurave të nderuara të kryeqytetit në fushat e ndryshme të artit, kulturës, letërsisë në bashkëpunim me Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve, 10 figura artistike për çdo figurë reklamacion + koktej nga 25 mijë lekë. Shuma 250 mijë lekë.

Projekti kulturor Nr.20

Libri – Jeta dhe vepra e patriotit Hafiz Ibrahim Dallit 150 mijë lekë.

Projekti kulturor Nr.21

Për seksionin e gruas dhe shoqatave.

- 1.Përkujtimore “Musine Kokalari”, gruaja në diktaturë, promovim libri – 150 mijë lekë.
- 2.Arsimi dhe gruaja në 7-8 Marsin, figura të shquara të arsimit të Tiranës në bashkëpunim me Shoqatën e Mësuesit pensionistë në bashkëpunim me Drejtorinë e Muzeumit – 95 mijë lekë.
- 3.Koncert spektakël me vepra të krijuara dhe interpretuara nga gratë artiste (Mars) 150 mijë lekë.
- 4.Ekspozitë e piktove femra në bashkëpunim me Shoqatën Linda 102 mijë lekë.
- 5.Tavolinë e rumbullakët për problemin Gruaja në Shoqërinë e sotme Roli i Femrës sidomos nënave të reja – 50 mijë lekë.
- 6.Tryezë e rumbullakët me gra artiste – Rrahje mendimesh. Roli i gruas në art. Mbrëmje poetike me krijime nga gratë – 70 mijë lekë.

Projekti kulturor Nr.22

Sektori i Rinisë

- 1.Rinia dhe interesat për poezinë. Krijimtari nga të rinjtë gjimnazistë dhe studentë. Mbrëmje poetike 57 mijë lekë.
- 2.Të rinjtë në artet vizive – Shoqata frymë Ekspozite – bota krijuese e të rinjve – 65 mijë lekë.
- 3.Të rinjtë dhe Ekologjia në formë konkursi mes shkollave të mesme programe : Pastrimi nuk mbaron tek dera e shtëpisë tuaj – 45 mijë lekë.
- 4.Shkolla e Verës për të rinjtë e Tiranës, kurse për fotografi artistike, pikturë, histori, art, skenografi etj 120 mijë lekë.

5.Piktura murale me temë ekologjike vepra e të rinjve .
Ekspozitë 85 mijë lekë.

6.Dita kundër Sidës dhe Drogës. Një javë veprimtari sensibilizim, shtyp radio TV biseda, takime, manifestime, propagandë, publicitet, poste, dekor afishe etj – 95 mijë lekë.

7.Java kulturore Të rinjtë dhe Dhjetori, veprimtari në art, kulturë, film, koncert – 90 mijë lekë.

Veprimtari Jashtë shtetit

(Sponsorizime të pjesëshme) Artistët tanë në skenat europiane.

Projekti kulturor Nr.23

Ansamblu artistik “Të rinjtë e Bashkisë së Tiranës”. I ftuar në dy festivale ndërkombëtare folklorike në Angli – Shpenzime udhëtimi, autobuz, naftë, vizë tranzite Itali – Francë dhe vizat angleze 6.977 USD, grupi artistik i përbërë nga 30 vetë.

Projekti kulturor Nr.24

Turneu i Orkestrës frymore të Bashkisë së Tiranës në Zvicër dt.10-15 Qershor 1998 e ftuar nga Banda e Zvicrës LALYRE COURTION e përbërë nga 35 vetë. Shpenzime udhëtimi autobuz, naftë, viza zviceriane dhe tranzit (Itali), shpenzimet e qëndrimit (fjetje, ushqim nga pala pritëse) shuma 3.850 USD.

Projekti kulturor Nr.25

Turneu “Virtuozët e rinj të Tiranës” në Austri, Hungari, shpenzime udhëtimi autobuz, naftë, viza etj për 22 vetë. Shuma 3.500 USD.

Projekti kulturor Nr.26

Turne artistik i korit të Bashkisë së Tiranës në Prevezë të Greqisë dhe Bajern të Gjermanisë. Gjatë muajit korrik 1998. Turneu i parë 2.000 USD. Turneu i dytë 6.500 USD më i

rëndësishëm turneu i Gjermanisë, shpenzime udhëtimi, naftë, autobuz, viza gjermane dhe tranzit Itali – Zvicër.

Projekti kulturor Nr.27

Ditë të Kulturës TIRANASE në Itali – Bashkia e Tiranës, Drejtoria e Kulturës, Shoqëria Tirana 2000, Shoqata CULTURA DEI MARI – VENEZIA ose BARI ose te ARBERESHET KALABRI.

Ansambli TIRANA koncert :

Ekspozitë fotografike TIRANA NE VITE

Ekspozitë e piktorit SADIK KACELI

Ekspozitë e librit për fëmijë dhe të rritur

Kori i Bashkisë repertor me këngë gregoriane bizantine (Jon Kukuzesh etj).

Gastronomi TIRANASE.

Shpenzime udhëtimi autobuz, naftë, viza për 60 vetë 13.000 USD.

Projekti kulturor Nr.28

Grupe artistike të huaj mysafirë në Bashkinë e Tiranës

Turneu i Bandës Zvicëriane në Tiranë në muajin tetor 1998 – 3 koncerte për 5 ditë bashkë me mbërritjen dhe largimin. Shpenzime hotel + ushqim – 4500 USD.

Grupi folklorik italian në Tiranë. Në vjeshtë i ftuar për 3 – 4 koncerte.

Grupi folklorik italian ANTICHE TRADIZIONI POPOLARI AGRIBENTO. Shpenzime qëndrimi (fjetje – ushqim 4.000 USD).

TRUPA PROFESIONISTE TE TEATRIT TE KUKULLAVE, VARIETESE DHE CIRKUT

Të ftuar në veprimtari jashtë shtetit me shpenzime nga të ardhurat e tyre financime të pjesëshme nga Bashkia.

Projekti kulturor Nr.29

Teatri Kukullave në Festivalin Ballkanik të teatrove të Kukullave në Rumani muaji shtator 1998 (takim i përvitshëm) 2700 USD.

Ky teatër është ftuar të marrë pjesë dhe në Festivalin Ndërkombëtar që zhvillohet në Pragë – Çeki (qershor) dhe në Austri në Tetor 1998.

Projekti kulturor Nr.30

Turneu i Cirkut të Tiranës në Dubaj – Takim Ndërkombëtar nga data 8 Mars deri 18 Prill 1998. Shpenzimet e qëndrimit nga pala pritëse deri me 18 vetë, gjysma e shpenzimeve të udhëtimit nga pala pritëse parashikohet në një shumë prej 6.500 USD.

Projekti kulturor Nr.31

Turneu i Teatrit të Varietesë në Maqedoni – Qershor 1998 (10 ditë) shpenzime udhëtimi, autobuz, naftë, dieta etj 4.193 USD “Pranverë në Shkup”.

KERKESA PER SHPENZIME NE FUSHEN E TEATRIT

Projekti kulturor Nr.32

1. Teatri eksperimental i Akademisë së Arteve

Vepra : RINOCERONTI I E.JONESKUT
Regjia : Milto Kultar
Skenografia : Agim Zajmi (Artist i Popullit)

Mbas realizimit të veprës në mbështetje edhe të një kontrate mes realizuesve dhe Drejtorisë së Kulturës do të financojë në shumën 200 mijë (nga 277 mijë që kanë kërkuar). Pagesa për stafin realizues.

2. Vepra skenike : SHTRENGATA nga W.SHAKESPEARE

Regjia : Altin Basha
Skenografia : Ilir Martini

Duke u mbështetur në akt – marrëveshje të financohet pjesa e buxhetit të grupit realizues.

Regjia	50.000 lekë
AS/Regjisor	25.000 lekë
Skenografia	50.000 lekë
Kostumografi	40.000 lekë
Koreografi	40.000 lekë
Menager	30.000 lekë
AS/Menager	10.000 lekë
Piktori realizues	20.000 lekë

Shuma 265 mijë lekë (nga 330 mijë lekë të parashikuar nga autorët).

3. Teatri privat “NJI” për vënie në skenë “Epopëja e Supës”.
Interpretues + reklamacion 350 mijë lekë.

NE FUSHEN E KINEMATOGRAFISE – FESTIVAL MESDHETAR I FILMIT ARTISTIK TIRANE 1998

Projekti kulturor Nr.33

FESTIVAL “MEDITIRANA”

Në këtë festival do të marrin pjesë disa vende të Mesdheut me produksion më të mirë të Filmit artistik.

Bashkia e Tiranës, Drejtorja e Kulturës për realizimin e këtij aktiviteti do të vërë në dispozicion shumë prej 650 mijë lekë.

Projekti kulturor Nr.34

Për realizimin e filmit dokumentar “Gjurmë në Arkitekturën e Kryeqytetit” nga S.K. Film Historik përmes filmit dokumentar, ndërtimet e Tiranës në gjysëm shekulli.

Production – Distribution (Saimir Kumbaro) Shuma.420 mijë lekë.

NE FUSHEN E ARTEVE VIZIVE E MONUMENTALE

SEKTORI I ARTEVE VIZIVE

Projekti kulturor Nr.35

- 1.Monumenti i “Viktimave” me autorët Arben Laze 3.000.000 lekë (Mars - Prill).
- 2.Tirana në artet figurative ekspozitë 100.000 lekë.
- 3.Ekspozitë e piktorit Sadik Kaceli (e prapambetur nga viti 1997) në kuadër të 85 – vjetorit – 200 mijë lekë.
- 4.Mirëmbajtje e veprave të artit në kryeqytet (memoriale, lapidarë, pllaka përkujtimore etj) 200 mijë lekë.
- 5.Monumenti i Sulejman Pashë Bargjini (Mulleti) 2.500.000 lekë.
- 6.Monumenti i Hafiz Ibrahim Dalliu – 4.000.000 lekë.
- 7.Baso relev për 4 Shkurtin – 1.500.000 lekë.
- 8.Ekspozitë e artit konteporan të piktorëve të Tiranës në bashkëpunim me fondacionin e artit konteporan shqiptar 150. mijë lekë.
- 9.Ekspozitë e Piktorë – Poetë organizohet për herë të parë me Tematikë nga ngjarjet e vitit 1997 – 110 mijë lekë.
- 10.Piktorët e kryeqytetit në veprimtari jashtë shtetit ekspozitë me vepra të zgjedhura – 3700 USD.

Projekti kulturor Nr.36

Panairi ndërkombëtar i Librit në Tiranë (nëntor 1998) Bashkia e Tiranës 500 mijë lekë në bashkëpunim me Institucione të vendit dhe të huaja.

Projekti kulturor Nr.37

Rikonstrukcioni i Biblotekave të Tiranës – Bashkia e Tiranës
AEDP (SOROS) – 700 mijë lekë.

Projekti kulturor Nr.38

Skenar filmi dokumentar TIRANA NE VITE nga Skënder
Jasa.Realizimi i S.K. Film – 350 mijë lekë.

Projekti kulturor Nr.39

Botime për Tiranën

Album guide TIRANA – Të dhëna historike kulturore (përmes
teksteve dhe fotografive me karakter turistik) 250 mijë lekë.

Historia e Tiranës nga S.Jane 50 mijë lekë

Botime dhe vepra e Zenel Bastarit 250 mijë lekë

1.Konferenca e bashkëjetesave të kulturave dhe besimeve fetare
në Ballkan – Tirana kryeqyteti i bashkëjetesës fetare – 15 Mars
– 70.000 lekë (të reja) në bashkëpunim me forumin DXD.

2.Festivali i Valles dhe Muzikës në Shqipërinë e Mesme Tiranë
10 Maj.

Në bashkëpunim me Durrësin, Elbasanin, Kavajën, Krujën.
Festivali i parë do të zhvillohet në Tiranë ; Është biseduar dhe
bashkërenduar me kryetarët respektivë të qyteteve të
mësipërme. 10 Maj 300.000 lekë (të reja).

3.Album i kostumeve popullore të Tiranës.

Tradita e Tiranës e pasqyruar në kostumet popullore dhe në
mjedisin përkatës. Shumëllojshmëria e tyre dhe natyra e mjedisit
përkatës.

Në bashkëpunim me Institutin e Kulturës Popullore Autor
Agron Xhangolli. Shuma 250.000 lekë.

4.Përshkrimi kulturor i Tiranës.

Botimim i përmuajshëm i aktiviteteve kulturore shkencore sportive për të gjitha institucionet që zhvillojnë aktivitetet në Tiranë, muze, qendra kuturore etj.

Bashkia në rolin e koordinatorit në bashkëpunim me Tirana 2000. Çdo muaj në vartësi në Tirazhit një vlerë variabël prej 10.000 deri 20.000 lekë.

5.Guidë e Tiranës

Artistike : Me disa vlera kulturore (foto) dhe institucionet kryesore administrative, artistike, kulturore, parqe, ambiente publike etj, të paraqitura në hartë. Vlera në lekë 300.000 lekë.

6.Katër deri në pesë poetë të rinj të Tiranës të financohen duke stimuluar krijimtarinë e tyre në fushën e poezisë në vlerën 30.000 lekë seicili.

Shuma : $5 \times 30.000 = 150.000$ lekë

Me qëllim që të gjallërohet jeta kulturore – artistike e studentëve, Pallati i Kulturës “Studenti” për muajin shkurt 1998 paraqet dy projekte për veprimtaritë që do të organizohen :

7.Mbrëmje Show studentor Nr.1

Koj veprimtari do të organizohet në formën e një spektakli gazmor. Veprimtaria do të ketë këngë, humor, balet, anekdota, vallzime etj.

Për të përballuar kërkesat e këtij aktiviteti kërkojmë :

- | | | |
|-------------------------|----------------|---------------|
| 1.Këngëtare | 3 x 5.000 lekë | = 15.000 lekë |
| 2.Humoristë | 3 x 5.000 lekë | = 15.000 lekë |
| 3.Çifte baleti | 2 x 3.000 lekë | = 6.000 lekë |
| 4.Prezantues programi 1 | | = 2.000 lekë |

SHUMA : 38.000 lekë

Aktiviteti do të zhvillohet në pallatin Studenti.

Mbrëmje Show Nr.2

Veprimtaria do të zhvillohet dt.20 Shkurt në Sheshin “Demokracia” për zhvillimin me sukses të këtij koncerti të madh kërkohet që nga ana juaj të përballohen këto shpenzime :

- | | | |
|-------------|----------------|---------------|
| 1.Recitues | 1 x 5.000 lekë | = 5.000 lekë |
| 2.Aktore | 4 x 5.000 lekë | = 20.000 lekë |
| 3.Këngëtare | 4 x 5.000 lekë | = 20.000 lekë |

4.Valltare 4 x 3.000 lekë = 1.200 lekë
5.Prezantues programi 1 x 3.000 lekë = 3.000 lekë

SHUMA. 60.000 lekë.

Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të dt.27.03.1998 u miratua si shtesë gjatë diskutimit të relacionit projekt – vendim “Për miratimin e projekteve kulturore të Drejtorisë së Kulturës, Arsimit, Sportit për vitin 1998” si më poshtë :

TIRANA – simbol i bashkimit kombëtar nga Sherif Delvina 180.000 .

Tradita ndërtimore në ndërtimin e Tiranës – grup autorësh.

Këto libra të shtohen në planin e v.1998.

2. Ky vendim do të zbatohet në bazë të vendimit të Këshillit Bashkiak mbi ndarjen e të ardhurave për çdo drejtori.
3. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Kulturës dhe Financës.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI